



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



10 Nr. Zyrtar – 2023  
Dt.: 20.02.2023

Komuna e Gjakovës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport - Sektori i Sportit do të bëjë zgjedhjen e laureatëve të dalluar në sport për vitin 2022.

### N J O F T I M

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Gjakovës, njofton të gjitha organizatat e regjistruara si OJQ, Klube apo Shoqata Sportive, që t'i dërgojnë propozimet e tyre për zgjedhjen e sportistëve më të mirë, të cilët duhen të bëhen ekskluzivisht nëpërmjet Klubeve Sportive. Propozimet bëhen për: **Sportistin, Trajnerin, Klubin, Shpresën e vitit, Referin** si dhe **Punëtorin Sportiv më të mirë**.

Gjatë propozimit për laureatë, në mënyrë të qartë duhet të përshkruhet aktiviteti i secilit sportist dhe të specifikohet pjesëmarrja në garat ekipore dhe individuale si p.sh. (Diplomat, Medaljet, Certifikatat, Arritjet, etj) në të cilat kanë garuar sportistët, klubet dhe sukseset të cilat i kanë arritur në nivel kombëtarë dhe ndërkombëtarë gjatë vitit 2022.

Propozimet për zgjedhjen e laureatëve më të mirë mund të bëhen përmes klubeve sportive dhe të dorëzohen fizikisht në Sektorin e Sportit – Pallati i Sporteve “Shani Nushi”

Rr. “Tirana”, p.n. 50 000 Gjakovë, më së largu deri më datën **24.02.2023 ora: 16:00**

Përzgjedhja e më të mirëve do të bëhet nga Komisioni i themeluar për këtë qëllim.

Me respekt!

Urim Fazlija

U.D i Udhëheqësit të Sektorit të Sportit - DKRS

KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Postal address: Nëna Terezë – Gjakovë, Kosovë / 50000 Tel: +381 390 322 591  
kk.rks-gov.net/gjakove/